



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1145/17

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI121/16

Parashtrues

Vera Otešević

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 123/16, të 6 qershorit 2016**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Vera Otešević (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), aktualisht me banim në Danilovgrad, të Republikës së Malit të Zi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 123/16, të 6 qershorit 2016, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ca. nr. 1251/2015, të 20 prillit 2015, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, P. nr. 26/13, të 5 shtatorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet shkelja e të drejtave të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2016, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 23 dhjetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga e njëjta kompletimin e kërkesës me dokumentacion relevant.
8. Më 3 shkurt 2017, parashtruesja e kërkesës, në Gjykatë, dorëzoi dokumentacion shtesë. Megjithatë dokumentacionit në fjalë nuk i janë bashkëngjitur kopjet fizike të vendimeve të kontestuara.
9. Më 4 prill 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, refuzimin e kërkesës me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend tekstualisht vendimet e kontestuara, me të cilat ajo pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare. Megjithatë, vendimet e sipërcekura nga parashtruesja e kërkesës nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesja e kërkesës pretendon se përfaqësuesja e saj me prokurë, kundër vullnetit të saj dhe pa dijeninë e saj ka vepruar në kundërshtim me interesat e saj në raport me të paditurin R. M. Si rezultat i këtij veprimi pretendon se *“gjkata e shkallës së parë nxori aktgjykimin e paligjshëm i cili atakohet me këtë ankesë”*.

12. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendon:

“Gjkata e shkallës së parë duhet në mënyrë formale, ligjore të më dorëzojë aktgjykimin e atakuar, dhe kështu të më mundësojë të drejtën e ankesës.

(...)

Aktgjykimi i gjykatës së instancës së parë ishte i paligjshëm sepse përfaqësuesja ime nuk e kishte të lejuar të ndërmerr veprimin në fjalë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të lejojë DISPONIMIN E TILLË TË PALEJUESHËM TË PËRFAQËSUESSES SIME, e cila më keqpërdori. Atëherë kur gjykata vëren se përfaqësuesi me prokurë punon në dëm të dhënësit të autorizimit, ajo është e detyruar të njoftojë dhënësin e autorizimit. Me këtë unë jam dëmtuar edhe në aspektin e të drejtave të mia kushtetuese, të së drejtës së pronës, pronësisë, sepse përfaqësuesja ime me prokurë ka vepruar në kundërshtim me interesin tim. Por, Gjykata e Apelit nuk i trajtoi këto pretendime.

(...)

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i paligjshëm dhe tërësisht absurd. Në të gjitha ligjet procedurale, edhe në Ligjin për Procedurën Kontestimore të Kosovës ekziston dispozita me të cilën përcaktohet në çfarë mënyre dorëzohen shkresat, aktgjykimet dhe vendimet e tjera të lidhura me afatet.

(...)

Mua nuk më janë dorëzuar shkresat në gjuhën time. Unë jam subjekt kryesor i procedurës, dhe jo përfaqësuesi im me prokurë. Dhe kjo shkelje e bën procedurën dhe gjykimin jokushtetues, e shkel të drejtën për gjykim fer dhe të ndershëm, gjegjësisht të drejtën për gjykim të drejtë. E lus Gjykatën që të pranojë këtë ankesë kushtetuese si të bazuar”.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
14. Kësisoj, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesave]

“4. Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...).”

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që përcakton:

29 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]”

32 (5) “Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën (...).”

16. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare, nga arsyet e cekura më lart.
17. Gjykata, bazuar në nenin 22.4 të Ligjit, kërkoi nga parashtruesja që të dorëzonte vendimin e kontestuar dhe vendimet tjera të gjykatave të rregullta.
18. Megjithatë, jashtë afatit të përcaktuar, Gjykata pranoi vetëm disa dokumente por jo edhe kopjet fizike të vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, kushtetutshmërinë e të cilave, Gjykata do të mund ta vlerësonte vetëm pasi të jenë plotësuar kriteret e kuruara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
19. Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtrueses së kërkesës pa dokumente dhe prova materiale mbështetëse, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës (shih, vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI03/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21).
20. Gjykata më tej konsideron se, parashtruesja nuk ka treguar rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e të gjitha kriterëve procedurale të pranueshmërisë.
21. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e përgjegjësisë bie mbi parashtruesen e kërkesës që nuk ka arritur të përmbushë kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
22. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h), 32 (5) të Rregullores së punës.

23. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

